

DAXOROL Kratzputz DX-700

■ **Vendet e përdorimit:** - Llac I plote mineral. Sherben per dekorimin e fasadave dhe siperfaqeve te brendshme sipas DIN 18350. Perdoret si shtrese perfundimtare mbi te gjitha llojet e llaceve ne baze cimente, gipsi, gips karton pllakave, dhe te gjitha sistemet e tjera izoluese.



■ **Baza e materialit:**

Rërë, çimento e bardhë, hidrat i gëlqeres së bardhë, lëndë e lehtë mbushëse dhe shtesa për përmirësimin e vetive përpunuese.

■ **Vetitë:**

DX 700 Kratzputz është shtresë përfundimtare për të gjitha WDV-sistemet, DX 10 Daxogrund si dhe për të gjitha bazamentet adekuate të afta për bartje.

■ **Kushtet e përpunimit:**

Gjatë përpunimit temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5°C. Deri të tharja e plotë duhet të mbrohet prej ngricës dhe rrezatimit direkt të diellit.

■ **Përgatitja e bazamentit:**

Bazamentet duhet të jenë të pastra, të afta për bartje dhe pa mbetje vajrash dhe yndyrash. Te gjitha siperfaqet paraprakisht doemos të lyhen me Daxorol Unigrund.

■ **Përgatitja:**

Thes prej 25kg DX 700 Kratzputz përzihet me 7,5 litra ujë deri në formimin e një llaçi pa toptha. Pas një kohe formimi prej 5 min. të përzihet shkurt me mikser. Perzierja me materiale te tjera nuk eshte e lejuar.

■ **Përdorimi:**

DX 700 Kratzputz të merret me një rrafshuese adekuate nga rostfraji, masa shtrihet dhe fiton forme strukturale me ane të rrafshuese artificiale (dërrasë) styropori me të cilën fitohet struktura e dëshiruar. Te të gjitha sipërfaqet duhet patur kujdes në sasinë e tërheqjes së suvasë - përndryshe mund të paraqiten devijime në strukture.

■ **Udhëzime për rreziqe:**

Përmban çimento/hidrat gëlqeror Xi irritues. Të mbrohen lëkura dhe sytë.

■ **Deponimi:**

Të deponohet në vend të thatë. Afati i përdorimit 12 muaj.

■ **Të dhëna teknike:**

Thes 25kg, ngjyrë e bardhë, madhësitë e kokrrës suva fërkuese: 1.5, 2 dhe 3mm. Pastrimi i veglave të punës të bëhet me ujë.